



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 29 gusht 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Nazane Breca, Time Kadriaj, Bahri Thaçi, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Mungoi: Fikrim Damka.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Time Kadriaj, nënkryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.08.2012;**
- 3. Raportimi i grupit të punës për monitorimin e Ligjit të punës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.08.2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 23.08.2012.

3. Raportimi i grupit të punës për monitorimin e Ligjit të punës

Time Kadriaj- Tha se jemi në fazën e shkruarjes së raportit për monitorimin e këtij ligji. Fjalën ia dha Liburn Aliut, kryesues i grupit të punës për monitorimin e këtij ligji.

Liburn Aliu- Tha se para vetes e kemi një raport të hartuar nga administratorja e Komisionit. Gjithashtu, kemi edhe një raport nga MPMS-ja, për zbatimin e këtij ligji.

Në këtë raport, rekomandimet përfundimtare të MPMS-së janë kryesisht të lidhura me pushimin e lehonisë. Kemi kërkuar raport nga Inspektorati, lidhur me punën e tyre në monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Pra, sikundër shihet, e kemi një material të mjaftueshëm për hartimin e një raporti të mirëfilltë. Një draft e kemi, për të cilin ne së bashku do të japim edhe propozime të tjera. Kemi pritur nga sindikatat që të na japin vërejtje me shkrim, lidhur me zbatimin e ligjit, por nuk na kanë sjellë asgjë të shkruar. MPMS-ja, në përgjigjet e saj në pyetjet tona, na është përgjigjur shkurtazi me çështjet e ngritura. Këtë draft-raport duhet ta plotësojmë me të dhëna të detajuara nga raportet e cekura. Do të ishte mirë që, secili nga ne, të japë propozimet e veta për rekomandimet eventuale në këtë raport. Një gjë, e cila nuk është evidentuar në raport dhe që duhet të adresohet, është çështja e kohëzgjatjes së kontratave. Pra, shkeljet e ligjit janë më të vogla në ndërmarrjet publike dhe në ndërmarrjet e mëdha private. Çështje tjetër që duhet të adresohet është pagesa e punëtorëve që punojnë në ditët e festave.

Time Kadriaj- Tha se është mirë që të gjitha vërejtjet të inkorporohen në pjesët përkatëse të raportit. Këtë do të mund ta bënim në një takim të grupit të punës për monitorim.

Salihe Mustafa- Deklaroi së është mirë që kryesuesi ta bëjë një raport me rekomandime, e më pas, ne si grup do të mund të shtojmë apo të heqim diçka nga ai raport.

Nazane Breca- Tha se do të ishte mirë që secili nga ne të përgatisim propozim-rekomandimet, e mëpastaj, të gjithë bashkë të dakordoheshim për rekomandimet përfundimtare.

Flora Brovina- Tha se duhet te jemi të vëmendshëm në hartimin e rekomandimeve. Duhet të japim jo shumë rekomandime, por që ato nuk duhet të jenë të ndikuara nga informatat ditore. Ne jemi dëshmitarë që OEK ka tjetër qëndrim nga Oda Ekonomike Amerikane. Duhet të sqarohen disa çështje, si p.sh. sa mjete janë harxhuar për realizimin e të drejtave nga pushimi i lehonisë dhe nga lëndimet në punë.

Sasha Gjokiq- Pati një vërejtje sa i përket materialeve dhe draft- raportit, i cili nuk është përkthyer në gjuhën serbe.

Liburn Aliu- Tha se, sipas planit të punës, kemi pasur për ta bërë një vizitë në MPMS, në fund të monitorimit. Unë jam që ta realizojmë këtë vizitë javën tjetër.

Bahri Thaçi- Tha se nuk duhet të punojmë më në këtë raport dhe nuk kemi nevojë ta konsultojmë MPMS-në për këtë çështje. Tek pasi ta hartojmë raportin, atëherë do të mund të flasim me Ministrinë.

Gëzim Kelmendi- Tha se do të ishte mirë që ne të hartojmë një raport komplet dhe si i tillë të jetë voluminoz. Kjo, sepse për raportin nga monitorimi i kaluar kemi pasur vërejtje nga deputetët për cilësinë e raportit.

Salihe Mustafa- Tha se është e vërtetë që jemi kritikuar për raportin nga monitorimi i kaluar, por ata që kanë kritikuar nuk kanë qenë në rrjedha të punës që ne kemi bërë. Ne duhet të japim rekomandim se a duhet të ndryshohet Ligji i punës.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit

Time Kadrijaj